



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 563

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Enida HIMAJ - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 17 Qershor 2017

FEJOHET XHENI DHE
BERNARDI, ÇIFTI SHIJON
MUAJIN E MJALTIT NE ITALI



ZGJEDHJET 2017


Ja si do të votojnë VIP-at shqiptarë

**Të zhgënjyerit,
të pavendosurit
dhe militantët
e showbizzit
shqiptar**



**Dorina Mema: Kam qenë e djathtë, por do votoj
Ramën, Inis Gjoni: Akoma s'e kam vendosur**

VIP-at NE PLAZH



**Rike ngre temperaturat, Enca
zgjedh Turqinë**





Pamela Aliaj

Duke qenë se na ndan vetëm një javë nga zgjedhjet e 25 qershorit, të shumta kanë qenë edhe përfshirjet e VIP-ave në fushatat zgjedhore të partive të ndryshme. Mund të përmendim humoristin e mirënjohur Besart Kallaku, i cili ka zgjedhur të mbështesë Partinë Lëvizja për Integrim, ndërsa Gazmend Paja, humoristi tjetër i "Portokallisë" ka zgjedhur të mbështesë Partinë Socialiste. Në spotin e tij publicitar ai mundohet të bëjë edhe batuta, duke u përfshirë në rolin e tij në "Portokalli". Nga ana tjetër kemi Oni Pustinën, modelin dhe postierin e njohur të ekranit italian, i cili shfaqet në emisionin e Maria de Filipi, "C'e posta per te", i cili ka zgjedhur të jetë pjesë e fushatës së LSI. Me ftesën e kryetarëve të partive apo duke trokitur vete ne dyert e tyre personazhe te njohur te artit shqiptar janë prekur nga ethet e fushatës. Ata janë të famshëm në fushën e tyre, por kur ndryshohen pushtetet herë shfaqen masivisht në ekran e herë zhduken fare si me magji. Kush për qejf apo për bindje të pastra politike e kush për ndonjë interes nën siglën e logove të partive, artistë e sportistë janë përfshirë në fushatën zgjedhore. Gjithsesi mund të themi se shumica e VIP-ave tanë nuk janë ende të bindur se për kë do të votojnë dhe këtë e shohim edhe në mos përfshirjen e tyre në lobime apo në fushata zgjedhore. "Bluetooth" ka zgjedhur të kontaktojë disa prej VIP-ave për të ditur se cila është zgjedhja e tyre në 25 qershor. Ja si janë shprehur ata:

Ja si do të votojnë VIP-at shqiptarë

Të zhgënjyerit, të dhe militantët

Dorina Memaj: Kam qenë e djathtë, por do votoj Ramën, Inis Gjoni: Akoma s'e kam vendosur

Jonida Maliqi

Këngëtarja e mirënjohur bukuroshe e kontaktuar nga "Bluetooth" nuk ka qenë e hapur në përgjigjen e saj. Ajo ka zgjedhur të mos prononcohet lidhur me zgjedhjen që do të bëjë në 25 qershor. Mesa duket bukuroshja brune nuk dëshiron që një përgjigje e tillë të ndikojë në karrierën e saj artistike dhe ka vendosur të zgjedhë heshtjen. "Nuk mund të them se për kë do të votoj se do të ndikoj në karrierën time prej këngëtareje. Nëse do ta thosha do më duhet të lloboja për atë parti. Por mund të them se do të votoj për një Shqipëri më të mirë."



Inis Gjoni

Regjisoria dhe showgirl-i, Inis Gjoni, ka qenë tepër e prerë në përgjigjen e saj lidhur me pyetjen se me kë do të votojë në 25 qershor. Për të, vota qëndron e fshehtë dhe nuk ka arsye përse të shprehet. Edhe pse regjisoria nuk ka dashur të thotë se për cilën parti do të votojë, ajo në fund të bisedës thotë se do të votojë për një Shqipëri më të mirë. Mos nënkupton kjo sloganin e Partisë Demokratike, ku kryefjala është Republika e Re dhe një Shqipëri më e mirë se kjo? "Nuk mund të them aspak se për kë do të votoj se s'do të quhej vota e fshehtë në të kundërt. Ata VIP-a që kanë thënë se me kë do të votojnë janë më shumë vip-a se unë. Mund të them që do të votoj për një Shqipëri më të mirë."



Olta Gixhari

Aktorja bukuroshe Olta Gixhari nuk ka preferuar të tregojë se cila do të jetë zgjedhja e saj për 25 qershor. Ajo ka thënë për "Bluetooth" se është e rëndësishme që të gjithë shqiptarët të ngrihen e të votojnë, thirrje kjo që të bën të mendosh që për Oltën vota është më se e rëndësishme dhe vendimi i shqiptarëve për të votuar për një të nesërme më të mirë është një slogan i njohur nga shumë parti. Gjithsesi, bukuroshja bionde e ka lënë të fshehtë vendimin e saj. "Nuk mund të them absolutisht se për kë do të votoj, por mund të them që u bëj thirrje shqiptarëve për të votuar të gjithë."

pavendosurit e showbizzit shqiptar



Dorina Mema

Një nga VIP-at, e cila ka zgjedhur të jetë e hapur me Bluetooth ka qenë sportistja e mirënjohur edhe në arenën ndërkombëtare, Dorina Mema. Ajo ka qenë shumë e qartë dhe e sigurt në përgjigjen e dhënë për gazetën. Vendimi i saj për zgjedhjet e 25 qershorit është më se i qartë pavarësisht bindjeve politike të sportistes. Ajo vendos që këtë herë votën ta jap për kreun e Partisë Socialiste, Edi Rama, dhe shton se është mirënjohëse për ndryshimet që i ka sjellë Shqipërisë. Ndërkohë që në një intervistë të bërë më parë për Gazetën Shqiptare, Dorina ka shprehur dëshirën për t'i shërbyer njerëzve të saj në politikë, duke nënkuptuar këtu, vendlindjen e saj, Krujën. "Unë e kam thënë që më parë që jam demokrate, por do t'i jap një mundësi Edi Ramës. Dhe i jam mirënjohëse për frymën e re dhe ndryshimin që ka sjellë."



Ilda Bejleri

Moderatorja bukuroshe e SuperSport, gjithashtu, nuk ka qenë e hapur në përgjigjen e saj. Ilda Bejleri e kontaktuar për "Bluetooth" nuk ka dashur të shpreh bindjen e saj politike duke thënë se një votë mbetet e fshehtë dhe se nuk dëshiron të përfshihet me politikën. Kjo është paksa e çuditshme edhe pse bukuroshja brune ka mbaruar shkollën për shkencë politike, edhe pse është drejtuese e një emisioni të sportit, ajo duhet të jetë më se e informuar dhe e përfshirë me politikën. Asnjëherë si dihet! "Nuk mund të them se për kë do të votoj."



Aurela Hoxha

Blogeria superseksi Aurela Hoxha, ka qenë një nga VIP-at, e cila ka qenë gjithnjë e njohur për drejtimin e saj politik. Edhe kësaj radhe, e kontaktuar nga "Bluetooth", ajo e ka shprehur hapur bindjen e saj politike. Aurela ka qenë dhe mbetet e djathtë edhe pse nuk ka qenë pjesëmarrëse e ndonjëres prej fushatave të Partisë Demokratike. Disa VIP-a nuk e kanë problem të shprehen, sepse s'kanë arsye përse! "Do të votoj për Partinë Demokratike, dihet, sepse e kam thënë dhe më parë."



Soni Malaj

Këngëtarja bukuroshe Soni Malaj nuk ka qenë shumë e sigurt në përgjigjen për "Bluetooth". E kontaktuar, Soni nuk ishte ende e vendosur se për kë do të votonte, dhe përgjigja e saj nuk ishte e vulosur. Ajo nuk ka qenë ndonjëherë pjesë e lobimeve të ndonjë partie, por edhe bindjet e saj politike nuk ka dashur t'i shprehë ndonjëherë hapur për publikun. "Nuk mund ta them se për kë do të votoj, sepse nuk e di ende për kë do të votoj me siguri."



Orgesa Zaimi

Këngëtarja e njohur e muzikës Klive, Orgesa Zaimi ka qenë e vetmja e kontaktuar, e cila ishte e bindur në zgjedhjen e saj kategorike. E pyetur për "Bluetooth", Orgesa është shprehur se nuk do të votojë këto zgjedhje të 25 qershorit. Mesa duket këngëtares së mirënjohur nuk i pëlqejnë kandidatët ose edhe më keq, mund të ketë qenë pjesë e ndonjë zhgënjimi në të shkuarën, ose edhe në të tashmen, nuk sheh asnjë parti të denjë për votën e saj. "Nuk mund të them se për kë do të votoj, sepse nuk do të votoj më 25 qershor."



VIP-a në plazh

Rike ngre temperaturat, Enca zgjedh Turqinë

VIP-at ngrënë temperaturat edhe për këtë vit. "Bluetooth" ka "udhëtuar" në vendet e ndryshme në të cilat janë akomoduar VIP-at e njohur, duke nisur nga brigjet e Shqipërisë e duke kaluar edhe kufijtë, deri në Turqi. Këtë verë sezonin e VIP-bikini e kanë hapur jo vetëm modelet si Rike Roçi, duke nxjerrë në pah format e duke provokuar me linjat super seksi, por kanë qenë edhe këngëtaret si Fjolla Morina, Enca Haxhia, Sheila Haxhiraj etj.

Nga Pamela Aliaj

Enca Haxhia

Në po hapim siparin e VIP-ave në plazh me mbretëreshën e "Instagramit", Enca Haxhia. Këtë verë ajo ka preferuar të udhëtojë jashtë vendit, si edhe verën e kaluar, dhe nuk ka harruar të na mbajë të përditësuar me momentet e saj që kalon gjatë ditës. Ajo tani është duke shijuar ditët e nxehta të verës në një resort në Turqi ku dhe nuk ka reshtur së publikuar foto e snape nga vende të ndryshme të resortit. Por nuk është mjaftuar me kaq, duke qenë se është mbretëreshë, titullin duhet ta mbajë fort dhe të mos harrojë të kënaqë dhe ndjekësit e saj në rrjetet sociale. Dhe kjo duket qartë në fotot e saj me bikini ku nuk i ka lënë vend imagjinatës. E tillë është Enca, provokuese dhe super seksi në fotot e saj. Një "ves" që i rrit më tepër temperaturat për verën e 2017-ës.



Rike Roçi

Dhe po e mbyllim faqen tonë të VIP-ave me bikini me bukurshen seksi, ish-banoren e Big Brother, Rike Roçi. Bukuroshja bionde ka zgjedhur për destinacion këtë fillim vere një nga plazhet jashtë vendit, e më saktë në Itali. Modelja bionde nuk harron të nxjerrë haptazi format e saj perfekte duke u bërë edhe më ndjellëse për ndjekësit e saj. Edhe këtë verë, Rikja duket se është në superformë dhe këtë e shfaqin mirë fotot provokuese me bikini në një nga plazhet e Italisë.

Elvana Gjata publikon këngën e re, një dedikim për Flor Mumajesin?

“Përgjithmonë ka mbaruar”

Vetëm pak ditë më parë Elvana Gjata publikoi këngën e shumëpritur “Forever is over”, e cila brenda pak kohësh ka arritur mbi 750 mijë shikime në “Youtube”. Mirëpo përveç muzikës, pamjes së Elvanës në klip etj., një kuptim të veçantë ka edhe teksti. Që nga titulli “Përgjithmonë ka mbaruar” kuptojmë se kemi të bëjmë me një ndarje. Ndoshta ndarja me Flor Mumajesin e ka frymëzuar Elvanën që të sjellë përjetimet e kësaj marrëdhënie në një këngë që po korr sukses edhe në arenën ndërkombëtare. Për t’ju bindur po ju sjellim tekstin e plotë të këngës që ta vlerësoni vetë, nëse ky është dedikimi i fundit për Flor Mumajesin.

Po mundohem të harroj,

Po mundohem të kuptoj

Kur ‘flaka’ (ndjenja) të jetë shuar, do largohesh?

Apo do gjesh një ‘flakë’ tjetër për të ndezur?

Në fund të historisë, do jesh gati të fillosh pjesën e dytë?

Shiko pas të shkuarën

Mos harro gjithçka kaluam

Kur përgjithmonë të ketë mbaruar, do jesh këtu?

A do ta kem shpirtin tënd, në çdo mënyrë?

Të premtoj se do të dua pas asaj dite

Përgjithmonë ka mbaruar, do jesh këtu?

Të mungon diçka, vetëm kur nuk e ke më

Kështu që është më mirë t’i korrigjoj më gabimet

tona

Nëse sheh dhimbjen në sytë e mi,

Më mbro dhe dhimbja nuk do të jetë për shumë

gjatë

Kur Përgjithmonë të ketë mbaruar, do jesh këtu? 2x


A do ta kem shpirtin tënd, në çdo mënyrë?

Të premtoj se do të dua pas asaj dite

Përgjithmonë ka mbaruar, do jesh këtu?

Kur Përgjithmonë të ketë mbaruar,

Kur Përgjithmonë të ketë mbaruar, do jesh këtu pranë meje?..




“Pasditja ime”, një format ndryshe që do të mbajë mbërthyer shikuesit

Ka nisur me ngjyra pasditja në TVSH dhe jo vetëm. Për herë të parë (përjashtoj ditën rozë, të premtën) mbledhen së bashku nën një logo emisioni Erjona Rusi dhe 3 moderatorët simpatike të munguara në ekran prej kohësh, Balina Bodinaku, Estela Ujka dhe Eriona Shehu. Nën autorësinë e Rezarta Nikës, këto figura do të jenë çdo ditë pranë audiencës me një veçori. Nëse Erjona Rusi vjen me emisionin e saj “blu” do të thote se do të trajtojë çështje ditë, për familjen, punën etj., Balina vjen në një emision me natyrë, udhëtime, turizëm, info mbi makinat, Erjona Shehu zbardh skenografinë në ngjyrë të bardhë, sepse jemi te mjekësia, ndërsa blogierja e dashur, Estela Ujka përqendrohet totalisht në fashion me evente, këshilla mode, tutoriale make-up etj., për ta mbyllur javën me Eraldo Rexhon me gossip. Autorja Rezarta Nika gjithnjë ka qenë e kujdesshme që të ofrohet ndryshe për audiencën. Kujtojmë emisionet e saj në “Vizion Plus”, emocionin i një dubli, femrat dhe më pas emisionet e përditshme në të paradites dhe pasdites në “Vizion Plus”. I urojmë këtij stafi të ri në TVSH, suksese dhe në ora 17:00, nga e hëna deri të premtën, jemi aty t’i shohim.



Sheila Haxhiraj

Es kishte se si të mungonte këngëtarja bukuroshë Sheila Haxhiraj. Njihet tashmë për pasionin e saj për modelingun edhe pse në një intervistë të mëparshme për “Gazetën Shqiptare” ajo ka thënë që e ka thjesht një hobi.



Sheila këtë radhë nuk ka harruar të hap sezonin e saj të verës me një set fotosh, të cilin nuk ka harruar ta postojë në rrjetet sociale. Tepër provokuese shfaqet bukuroshja brune, e cila me pozat e saj me



bikini tregon linjat e saj seksi dhe tepër në formë. Mesa duket këngëtarja ka zgjedhur të shijojë brigjet e Shqipërisë si fillim i kësaj vere, e cila ka për të qenë tepër e nxehtë.




Fjolla Morina

Po e vazhdojmë kolazhin tonë të VIP-ave me këngëtarën kosovare Fjolla Morina. Bukuroshja brune është një tjetër artiste, e cila ka zgjedhur, gjithashtu, Turqinë për të shijuar rrezet e diellit të qershorit. Edhe Fjolla është shumë aktive në rrjetet sociale dhe nuk harron të “kënaqë” fansat e saj me foto të shkëputura nga pushimet e saj në një nga resortet e Turqisë. Por s’mjaftohet me kaq, Fjolla super seksi nuk harron të nxjerr edhe linjat e saj provokuese e veshur me bikini duke i çmendur fansat me trupin e saj perfekt.

Fejohet Xheni dhe Bernardi

Çifti shijon muajin e mjaltit në Itali



Dyshja që u njoh në "Big Brother" duket se po e shijojnë lidhjen e tyre edhe jashtë. Ashtu si bëhet me dije, çifti e ka zyrtarizuar tashmë marrëdhënien. Pasi Bernardi ka takuar familjarët e Xhenit dhe kjo e fundit prindërit e partnerit të saj, çifti po shijon disa ditë "muaj mjalti". Të dy kanë lënë pas tashmë eksperiencën e tyre në "Big Brother" duke u njohur më mirë, por pse jo duke kaluar edhe më shumë kohë me familjarët e njëri-tjetrit. Që pas daljes të dy nuk janë shfaqur shumë në media, apo në rrjetet sociale, duke preferuar të kalojnë kohë të veçuar. Ashtu si edhe në "reality-show", ky çift vijon edhe jashtë me xhelozitë e vogla dhe plot batuta.


Fiorentina sulmon Fotininë: Grua që rri me këmbë përpjetë

Fiorentina diskuton me Ambran dhe Olsin debatet me çiftin Danjel dhe Fotini. Për këtë të fundit, Fiorentina, që dikur ndante diskutime të ndryshme dhe shpesh ishin në krah të njëra-tjetrës, ka një tjetër mendim tashmë. "Ai (Danjeli) pse nuk shikon gruan e tij, që e ka me këmbë përpjetë, por shikon këtej?!", thotë ajo. Më pas, shton se për Danjelin ka një "gurë në dorë", duke nënkuptuar një episod që i ka rënë në sy gjatë kohës kur në shtëpi ishte Elsamedi. Ambra ndan të njëjtin mendim. "Epo këta mendojnë se kur thua më fal i ke të mbyllura të gjitha muhabetet", thotë ajo.



U bë xheloze për Ambrën, Katerina përzë Lupçen nga dhoma e gjumit

Katerina u bë xheloze pas afrimeve të Lupçes me Ambrën gjatë një loje dhe këtë ia shprehu edhe më herët partnerit të saj, Lupçes. Por mërzitja e Katerinës zgjati gjatë dhe kur Lupçe u fut në dhomën e liderit, ajo i kërkoi të largohej dhe të shkonte të flinte vetëm. Lupçe nuk e zgjat shumë këtë herë, por merr rrobat e tij dhe largohet nga dhoma e liderit. Fiorentina e pyet më pas se pse nuk fle me Katerinës, mos ndoshta janë zënë, por Lupçe i thotë se është shumë vapë dhe mohon të jetë grindur me Katerinën.



Por Fiorentina nuk e beson shumë dhe shkon te Katerina. "Pse fle vetëm? Pse iku Lupçe?", i thotë ajo Katerinës, e cila i përgjigjet që nuk e di pse ai iku. "Nuk është mirë t'ju shohin kështu. Nuk ka lezet, ju shohin të tjerët", i thotë Fiorentina. Ajo duket e vendosur për ta pajtuar çiftin. Shkon sërisht te Lupçe. "Pa çohu një çik ti. Ajo më tha që nuk të kishte thënë asnjë gjë. Pse ike?". "Çfarë t'i bëj unë asaj, boll i jam lutur, pse më rri mua me turinj të varur", thotë Lupçe. Por duket se Fiorentina ia ka zbuluar pikën e dobët. Ajo i flet për lojën dhe se në këtë mënyrë ai rezikon, sipas saj dhe këtu Lupçe nuk mund të kundërshtonte më. Më në fund Fiorentina ia arriti qëllimit dhe Lupçe iu bashkua Katerinës, megjithëse i qëndronte larg në krevat, ata e kaluan natën bashkë...